

Ne per gjithesi, punimet e shkatterimit do te fillojne duke zhvendosur sa me shume ngarkesa te vdekura qe te kete mundesi pa nderhyre ne elementet e strukturave kryesore. Punimet e perko hshme do te projektohen per te mbajtur ngarkesat e kerkuara ne rastin me te disfavorshem. Ne sektionet qe do te shkaterrohen do te perdoren mjete te pershtatshme ngritese, dhe me pas do te priten dhe ne pjeset e vogla do te ulen ne toke e do te jene nen kontroll. Per dorimi i eksplozivit eshte i ndaluar.

Çdo skeleri e kerkuar do te projektohet dhe ngritet ne perputhje me standartet perkatese. Ngritja e skelerive do te kryhet nga një specialist skelash kompetent dhe me eksperience dhe do te jetë e pavarur. Kontraktori duhet te siguroje qe kryhen te gjitha modifikimet e duhura qe kerkohen per skelat ne menyre qe te sigurohet qendrueshmeria e tyre gjate vazhdimit te punimeve. Duhet te tregohet kujdes qe ngarkesa e çdo mbledhje

mbeturinash ne skelet te mos tejkaloje ngarkesen e projektuar. Duhen marre te gjitha masat e duhura qe te parandalohen zhvendosjet aksidentale te mbeturinave nga platforma. Skelat duhet te jene gjate gjithe kohes se perdorimit dhe te perdoren per qellimin qe ato jane parashikuar dhe do te aprovojen nga Supervizori.

### 7.3 Kushtet e Sigurimit Teknik.

Kontraktori duhet te siguroje qe kantieri dhe paisjet jane:

- Konform ligjeve dhe rregullave te nxjerra nga Autoritet Shqipetare.
- Te nje standarti dhe tipi te pershtatshem duke pasur parasysh vendin dhe llojin e punimeve qe do te kryhen.
- Ne ngarkim te punonjesve kompetente dhe me eksperience.
- Te mirembajtura ne gjendje te mire pune gjate gjithe kohes.

Gjate punimeve te shkatterimit punonjesit duhet te kene veshje te pershtatshme mbrojtese ose mjete mbrojtese si helmeta sigurie, syze mbrojtese, mbrojtës veshesh dhe frysma rrethuese.

Duhet te menjanohet çdo mbingarkim ne ndonje pjese te struktura me mbeturina dhe materiale. Duhet te tregohet kujdes qe gjate uljes se mbeturinave ose materialeve te parandalohen lekundjet, reniet e lira, metoda te atilla qe shkaktojne rrezik per sigurine e personelit, struktura rrethuese ose prones publike te çdo lloji.

Kontraktori do te vendose rrjetet mbrojtese, rrethime dhe bariera per te parandaluar deme aksidentale ndaj personave ose demtime te pronave nga renia e materialeve dhe mbeturinave.

Kur per shkatterrim vihen ne perdorim makineri mekanike si vinça, eksavatore hidrauliike dhe thyerë shkembinjsh, duhet te tregohet kujdes te sigurohet qe asnjë pjese e ketyre makinerive te vihet ne kontakt me ose t'i afrohen nga siper ose nen kabllot dhe telat e energjisë elektrike dhe telefonit. Kontraktori duhet te informoje Autoritet Perkatese ne kohen e duhur para fillimit te punimeve qe keto Autoritete te marrin masat e nevojshme per mbulimin ose ndryshimin e drejtimit te kabllave.

### 7.4 Pagesa.

Rrethimet jo me mure dhe ndertesat e vogla me rezistence te ulet Jane te perfshira ne zerat per germim dhe per gatitjen e bazamentit mbushes. Punime shkatterimi te tjera mbulohen nga zerat perkates te Preventivit.

SEKSIONI 8

TOMBINOT RRETHORE

12.1 Te Pergjithshme.



Betonimi i tombinove rrethore prej betoni do te realizohet per pjesen e ulet te tubit duke perdorur forma te thjeshta. Per pjesen e siperme do te perdoren forma speciale me leshim te shpejte. Gjithashtu mund te perdoren per betonim edhe forma pneumatike.

Kur perdoren tuba çeliku per te cilat kerkesat e mesiperme jane aplikuar gjithashtu, ato duhet te jene nga nje fabrike e specializuar me nje diameter uniform dhe me trashesi ne perputhje me udhezimet e Inxhinierit. Ato duhen trajtuar dhe punimi duhet te jetë perfekt, pa plasaritje me forme te persosur ne ekstremitete, per te siguruar nje lidhje te pakalueshme nga uji.

Normalisht tubat do te instalohen ne vije te drejte dhe ne nivelin e percaktuar dhe mbi nje jastek betoni te varfer me trashesine e percaktuar nga Inxhinieri. Ato gjithashtu do te rrethohen me llaç betoni sipas perpjestimeve te kerkuara dhe konfigurimin e paraqitur ne vizatimet e projektit, pas nje ngjitejeje perfekte te fugave me llaç çimento.

**Trashesia e sugjeruar e mureve te tubave dhe jastekve eshte si me poshte:**

Diametri (cm)	Trashesia e Paretit (mm)	Trashesia e Jastekut (mm)
80	70	20
100	85	25
120	100	35
150	120	50

**SEKSIONI 9**

SHOQERIA "SIRE-ALB" sh.p.k

Administrator

Ing. Renaldo KARAJ

